VENDIM
Nr. 145, datë 31.10.2014

PËR REVOKIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP" SHA

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 4, të ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006, "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", të ndryshuar, dhe nenit 155, germa "g", të ligjit nr. 52, datë 22.5.2014, "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

konstatoi se:

Autoriteti me vendimin nr. 133, datë 30.9.2014, ka miratuar bashkimin me përthithje të shoqërisë së sigurimit "Interalbanian Vienna Insurance Group" sh.a. (shoqëria e përthithur) me shoqërinë e sigurimit "Sigma Vienna Insurance Group" sh.a. (shoqëria përthithëse).

Në datën 9.10.2014, Qendra Kombëtare e Regjistrimit ka kryer regjistrimin e bashkimit me përthithje të shoqërisë së sigurimit "Interalbanian Vienna Insurance Group" sh.a. (shoqëria e përthithur) me shoqërinë e sigurimit "Sigma Vienna Insurance Group" sh.a. (shoqëria përthithëse) në përputhje me dokumentacionin e depozituar.

Në bazë të nenit 220, germa "c", regjistrimi i bashkimit të shoqërive pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit bën që shoqëria që përthithet të vlerësohet e prishur, ndaj çregjistrohet nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, sipas seksionit V të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", pa kaluar në procesin e likuidimit.

Në bazë të nenit 155, germa "g", të ligjit nr. 52, datë 22.5.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", Autoriteti i revokon licencën shoqërisë së sigurimit për të ushtruar veprimtari sigurimi nëse shoqëria e sigurimit prishet.

Për sa më sipër, Autoriteti

VENDOSI:

1. Revokimin e licencës së shoqërisë së sigurimit "Interalbanian Vienna Insurance Group" sh.a., për të ushtruar veprimtari sigurimi në Republikën e Shqipërisë.

2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimin dhe publikimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Enkeleda Shehi